REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i barazisë gjinore dhe mirëqënies sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.50,datë 30.04.2025, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE NGA PROGRAMI I STREHIMIT "SUBVENCIONIMIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË DHE MASËS MUJORE TË PAGESËS PËR VITIN 2025"

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 113 pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2 , si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim , sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvensionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendim Këshilli Bashkiak Nr 7 datë 30.01.2025 ,Vendim të Komisionit të Strehimit nr.2 datë 16.04.2025.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Sarandë ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të pikës 34, 45 neni 2, neni 33, 34 të ligjit nr 22/2018 "Për Strehimin Social", Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2 , si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", si dhe duke u mbështetur në Ligjin Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", pika 5 neni 5, ku pas marrjes së fondit takues nga buxheti i shtetit, Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton listën përfundimtare të përfituesve të

cilët kanë plotësuar dokumentacionin dhe mund të fillojnë të marrin pagesën për subvencionimin e qerasë në tregun e lirë. Për këtë arsye komisioni i strehimit i mbledhur në datë 16.04.2025 vendosi të aprovojë listën me 29 familje të cilat kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar me pagesën e subvencionimit të qerasë në tregun e lirë. Me Vendim Këshilli Bashkiak Nr 7 datë 30.01.2025 iu ka lindur e drejta për të përfituar nga ky program 38 familjeve por 9 familje nga këto nuk do ta përfitojnë pagesën e subvencionimit të qerasë në tregun e lirë pasi nuk kanë paraqitur dokumentat e nevojshme, si kontratën e qerasë dhe vërtetimin mbi pronësinë e banesave, dokumente të cilat janë të detyrueshme bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore".

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)
Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Kujdesit Social dhe e Finances, bashkia Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social dhe e Finances, në bashkinë Sarandë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

Impakti social / grupet që preken:
Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 28.04.2025, shqyrtoi projektvendimin nr.50,datë 30.04.2025,relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për " PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE NGA PROGRAMI I STREHIMIT "SUBVENCIONIMIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË DHE MASËS MUJORE TË PAGESËS PËR VITIN 2025", paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   Miratimin e projektaktit

Laureta Çeçi **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë 28.04.2025